




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 2005, 2006 dhe 2007



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 2005, 2006 dhe 2007



**Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo**

Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)

Data e botimit: Dhjetor 2009

© : Enti i Statistikës së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ESK-së
në internet: www.ks-gov.net/esk

P a r a t h ë n i e

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) duke respektuar dhe zbatuar rekomandimet dhe rregulloret e Eurostatit në kuadër të punëve dhe hulumtimeve të veta të rregullta organizon dhe përcjell edhe Anketën Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN) . Me këtë hulumtim kemi filluar në vitin 2006 duke grumbulluar të dhënat për vitin referues 2005, për të vazhduar me të njëjtën edhe në vitet në vijim . ASN është pjesë përbërëse e Programit statistikor të ESK dhe bazohet në deklaratimet e ndërmarrjeve.

Kjo anketë me të dhënat që ofron, synon të paraqet strukturën e aktiviteteve ekonomike nëpërmjet treguesve ekonomik.

Rezultatet e të dhënave nga Anketa strukturore e ndërmarrjeve janë burim i rëndësishëm në përpilimin e Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit.

Ky publikim është publikim i rregullt i ESK-së dhe paraqet të dhënat nga ASN për vitet 2005,2006 dhe 2007. Është pjesë e punëve të rregullta në planin vjetor të ESK-së, me mundësi zgjerimi me parametra tjerë të nevojshëm për shfrytëzuesit dhe vendimmarrësit.

ESK falënderon të gjitha ndërmarrjet që bashkëpunuan në mënyrë korrekte, Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë ARBK - *MTI* dhe Administratën Tatimore të Kosovës (ATK)- *MEF*.

ESK gjithashtu falënderon në mënyrë të veçantë zyrtarët e zyrave rajonale të ESK dhe anketuesit nga departamenti , të cilët kanë qenë të kyçur në grumbullimin e të dhënave nga ndërmarrjet , për kontributin dhe angazhimin e tyre vetëmohues.

Komentet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura.

Ky publikim është përgatitur nga personeli i Departamentit të statistikave ekonomike dhe LLK: Ilir T. Berisha - Drejtor i Departamentit, Hysni Elshani, Valdete Navakazi, Muhamet Kastrati, Luljeta Krasniqi, Nazmije Belegu, Ibrahim Rrustemi.

Dizajnoj: Ahmet Cakolli

Dhjetor, 2009

Kryeshefi Ekzekutiv i ESK-së,
Z. Avni Kastrati

Shkurtesat

ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
BPV	Bruto Produkti Vendor
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NKVE	Nomenklatura e klasifikimit të aktiviteteve ekonomike
ARBK	Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
:	Shifrat mungojnë
n/a	Nuk aplikohet

P ë r m b a j t j a

	Faqe
1 Objektivat, metodologjia dhe shtrirja e anketës.....	5
1.1. Objektivat dhe shtrirja e anketës	5
1.2. Metodologjia.....	5
1.3. Nomenklatura e Klasifikimit të Veprimtarive Ekonomike (NKVE).....	6
1.4. Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës.....	7
1.5. Dizajnimi dhe përmbajtja e pyetësorit	8
1.6. Procedurat e shpërndarjes, anketimit dhe mbledhjes së të dhënave	9
1.7. Ngritja e të dhënave të anketës strukturore të ndërmarrjeve në nivel të vendit	9
2 Disa tregues dhe përkufizime themelore.....	10
3 Numri i bizneseve, të punësuarve dhe paga mesatare.....	11
3.1. Numri i bizneseve sipas aktiviteteve ekonomike.....	11
Tabela 1. Korniza për mostër e bizneseve aktive për vitet 2005,2006 dhe 2007	11
Tabela 2. Struktura e bizneseve sipas aktiviteteve ekonomike për vitet 2005, 2006 dhe 2007.....	12
3.2. Numri i të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike.....	13
Tabela 3.- Numri i të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike - ASN 2005, 2006 dhe 2007.....	13
Tabela 4.- Struktura e të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike ASN 2005,2006 dhe 2007.....	14
3.3. Paga mesatare sipas aktiviteteve ekonomike.....	15
Tabela 5. Paga mesatare mujore sipas aktiviteteve ekonomike për vitet 2005, 2006 dhe 2007.....	15
4 Qarkullimi dhe shpenzimet	16
4.1. Qarkullimi.	16
Tabela 6. - Struktura e qarkullimit sipas aktiviteteve ekonomike për ASN 2005, 2006 dhe 2007.....	16
4.2. Shpenzimet	18
Tabela 7.-Struktura e shpenzimeve sipas aktiviteteve ekonomike për ASN 2005, 2006 dhe 2007.....	18
5 Shtojcë	20
Tabela 1. Bizneset sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë për ASN 2005, 2006 dhe 2007 - (me përgjigje komplete).....	20
Tabela 2. Struktura e bizneseve sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë per ASN 2005, 2006 dhe 2007 (me përgjigje komplete).....	21

1 Objektivat, metodologjia dhe shtrirja e anketës

1.1. Objektivat dhe shtrirja e anketës

Qëllimi kryesor i Anketës Strukturore të Ndërmarrjes është paraqitja e strukturës së aktiviteteve ekonomike në Kosovë nëpërmjet treguesve ekonomik.

Rezultatet e të dhënave nga ASN janë burim i rëndësishëm i përpilimit të Bruto Produktit Vendor të Kosovës me qasjen e prodhimit. Anketa synon t'i plotësojë kërkesat për informacion më të plotë statistikor në kushtet e ekonomisë së tregut dhe ofron të dhëna mbi aktivitetin ekonomik e financiar të ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitetet në të gjithë territorin e vendit.

Anketa strukturore e bizneseve është gjithpërfshirëse dmth shtrihet në tërë territorin e vendit . Ky hulumtim bazuar në rregulloret dhe rekomandimet e Eurostatit mbulon këto seksione të NKVE-së:

- C** - Industria nxjerrëse
- D** - Industria përpunuese
- E** - Energjia, prodhimi dhe shpërndarja e ujit
- F** - Ndërtimtaria
- G** - Tregëtia, riparimi i automjeteve dhe artikujve shtëpiakë
- H** - Hotelet dhe restorantet
- I** - Transporti dhe telekomunikacioni
- K** - Pasuritë e patundshme, dhënia me qirra dhe shërbime për ndërmjetësim
- O** - Shërbimet kolektive sociale dhe personale

Në anketë nuk përfshihen këto seksione gjegjësisht degë të aktiviteteve ekonomike: **A - bujqësia, pylltaria, B - peshkimi, J - financat, L - administrata publike si dhe organet dhe organizmat ndërkombëtare, pasi që këto degë janë pjesë e hulumtimeve tjera.**

Anketat në teren kanë zgjatur dy deri në tre muaj (nga gjysma e korrikut e deri në fund të shtatorit për vitet paraprake).

Bashkëpunimi me bizneset për realizimin e kësaj ankete ishte i kënaqshëm, edhe pse një numër jo i vogël i bizneseve ka refuzuar të përgjigjet, poashtu edhe për shkak të mos-azhurnimit të adresave disa nga bizneset nuk kanë mund të gjenden. Numër i caktuar kanë hezitur të japin përgjigje në disa nga pyetjet të cilat ata i kanë konsideruar të ndjeshme .

1.2. Metodologjia

Metodologjia e përdorur për përpilimin e instrumenteve për anketë (pyetësorëve dhe udhëzuesve), nomenklatura dhe përgatitja e të dhënave për publikim, është bërë sipas rregulloreve dhe rekomandimeve mbi hulumtimet statistikore të Eurostat-it.

Me rastin e përgaditjes dhe nxjerrjes së mostrës është aplikuar metoda shkëputjes (cutt-off). Që do të thotë se nga numri total (populacioni) i bizneseve aktive (ato të cilat kanë deklaruar njërën nga format e deklarimeve pranë ATK) përmes metodës së shkëputjes janë nxjerrë ndërmarrjet me qarkullim vjetor mbi 50.000 euro në vit.

1.3. Nomenklatura e Klasifikimit të Veprimtarive Ekonomike (NKVE)¹

A	BUJQËSIA GJUETIA DHE HORTIKULTURA
B	PESHKIMI
C	INDUSTRIA NXJERRËSE ²
D	INDUSTRIA PËRPUNUESE
E	PRODHIMI, SHPERNDARJA E ENERGJISË
F	NDËRTIMI
G	TREGËTIA, RIPARIMI I AUTOMOBILAVE DHE ARTIKUJVE SHTËPIAK
H	HOTELET DHE RESTORANTET
I	TRANSPORTI DHE TELEKOMUNIKACIONI
J	AKTIVITETI FINANCIAR
K	PASURIT E PATUNDSHME, DHENIA ME QIRA DHE SHËRBIME PËR NDËRMJETËSIM
M	ARSIMI
N	SHËNDETËSIA DHE VEPRIMTARITË SOCIALE
O	SHËRBIME KOLEKTIVE SOCIALE DHE PERSONALE
P	SHËRBIME SHTËPIAKE
Q	AKTIVITETE TË ORGANIZATAVE DHE ORGANIZMAVE NDËRKOMBËTARE
R	AKTIVITETE TJERA BIZNESORE

¹ Nomenklatura e Klasifikimit të Veprimtarive Ekonomike (NKVE) është mjet statistikor për klasifikimin e ndërmarrjeve sipas aktivitetit të tyre ekonomik, shërben për përpunimin e të dhënave statistikore dhe ka gjetur zbatim në të gjitha vrojtimit pranë ndërmarrjeve.

² Në këtë seksion janë të përfshira edhe aktivitetet e minierave, gjegjësisht gurthyesve dhe separacioneve të zhavorrit dhe rrrërs. Për qëllime me praktike ne do ta përdorim termin shkurt "Minierat dhe industria nxjerrëse".

1.4. Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës

Për krijimin e kornizës së mostrës janë shfrytëzuar të dhënat nga :

- Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) – MEF kryesisht për përcaktimin e kornizës së mostrës për qarkullimin vjetor të ndërmarrjeve dhe numrin e të punësuarve.
- Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) MTI – (adresa, pronari, telefoni) dhe aktivitetet ekonomike të koduara sipas Nomenklaturës së Klasifikimit të Aktiviteteve Ekonomike NKVE Rev 1. ("NACE Rev 1. eng). Për bizneset e përfshira në anketat në vitet në vijim aktivitetet ekonomike janë azhurnuar edhe me të gjeturat nga terreni përmes anketave të viteve paraprake.

Të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës kanë qenë bazë për përcaktimin e kornizës së mostrës. Të gjitha bizneset që kanë deklaruar njërin nga tatimet për vitet 2005, 2006 dhe 2007 janë konsideruar si ndërmarrje aktive.

Të dhënat nga agjencioni për regjistrimin e bizneseve të Kosovës kanë shërbyer për: adresën e ndërmarrjes, aktivitetin kryesor sipas NACE Rev.1.1 emrin e pronarit ose personit kontaktues, numrin e telefonit (për këtë qëllim janë shfrytëzuar edhe regjistra dhe burime të tjera që mbajnë regjistra të ndryshëm telefonik).

Domethënë popullacioni apo korniza për mostrën e anketave është bërë me integrimin e të dhënave nga të dy burimet administrative .

Për zgjedhjen e mostrës janë përdorur dy kritere:.

Kriteri i *pare* për përzgjedhjen e mostrës ka qenë gjithë përfshirja e bizneseve me qarkullim vjetor mbi 50 000 euro në vit.

Kriteri i *dyte* për vitin 2005 ka qenë numri i të punësuarve. Kështu ndërmarrjet që kanë pasur mbi 10 të punësuar janë zgjedhur në mostër edhe nëse nuk e kanë plotësuar kriterin e *pare*. Ndërsa për vitin 2006 respektivisht 2007 me qëllim të mbulimit sa më të mirë të seksioneve ekonomike, si kritere është përdorur parimi i mbulimit të seksioneve ekonomike q.d.th. janë zgjedhur ndërmarrjet me qarkullim vjetor nën 50 000 euro për seksionet e aktiviteteve ekonomike të të cilat nuk kemi pasur biznese sipas kriterit të parë.

		2005	2006	2007
1	Korniza (Popullimi)	36.625	34.025	37.839
2	Mostra	3211	3211	3347
3	Madhësia e mostrës %	8.8	9.4	8.8
4	Përgjigje (a+b)	2631	2091	1931
	a) Përgjigje të kompletuara	2441	1881	1701
	b) Me përgjigje jokomplete	190	210	230
5	Norma e përgjigjeve %	81.94	65.12	57.69
6	Pa përgjigje*	580	1120	1416

*Biznese që kanë refuzuar apo nuk janë gjetur adresat

1.5. Dizajnimi dhe përmbajtja e pyetësorit

Varësisht prej nevojave të të dhënave është bërë përgatitja e pyetësorit. Plotësimi i kërkesave për llogaritë Kombëtare respektivisht për përpilimin e bruto produktit vendor në qasjen e prodhimit, ka qenë qëllimi kryesor.

Pyetësori i përdorur për grumbullimin e informacionit pranë bizneseve është konceptuar në 2 pjesë:

- Rubrika e përbashkët, me të dhëna të përgjithshme për të gjitha bizneset.
- Rubrika specifike, e cila përmban tregues specifik për çdo aktivitet ekonomik.

Fillimisht *pjesa apo kapitulli i parë* ka të bëjë me pjesën identifikuese të biznesit me të dhëna si: numri i regjistrimit të biznesit, emri i biznesit, përshkrimi i aktivitetit ose aktiviteve nëse ka patur dy a më tepër aktivitete, adresa e saktë, emri i pronarit, gjegjësisht pronarëve, personi kontaktues dhe koha kur është kryer anketa.

Kapitulli i dytë përmban: numrin e të punësuarve, numrin e pronarëve që punojnë, numrin e anëtarëve të familjes që punojnë pa pagesë dhe numrin e të punësuarve me pagesë. Të gjitha këto të ndara në kategori sipas gjinisë³.

Kapitulli i tretë përmban pyetjet për koston e personelit, pagat dhe mëditjet duke përfshirë edhe pjesën e pensioneve që biznesi i paguan për të punësuarit⁴.

Kapitulli i katërt ka të bëjë me qarkullimin e ndërmarrjeve dhe atë për mallrat e prodhuara nga biznesi, mallrat nga tregtia, shërbimet e kryera dhe nën-kontraktuesit. Në fund të pyetësorit për bizneset që kanë pasur dy e më tepër aktivitete ekonomike është shtuar si aneks i kapitullit të katërt IV, si IVA për informim analitik dhe për qëllim të identifikimit të aktivitetit kryesor dhe aktiviteve tjera të ushtruara nga bizneset.

Kapitulli i pestë përshinë blerjet që biznesi ka kryer për zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Në këtë kapitull përfshihen të gjitha llojet e shpenzimeve të biznesit minus pagat dhe mëditjet, minus blerjet për qëllime të investimeve, minus tatimet e paguara dhe pagesat tjera që nuk janë në funksion të prodhimit si p.sh dënimet gjyqësore etj.

Kapitulli i gjashtë ka të bëjë me tatimet, taksat.komunale, taksat mbi licencimin,tatimin në pronë etj.të paguara nga biznesi për periudhën vjetore.

Kapitulli i shtatë ka të bëjë me gjendjen në fillim dhe në fund të vitit të stoqeve për: repromaterial, karburante pajisje të vogla, për mallrat e blera për rishitje, për gjysmë prodhime dhe për prodhime finale.

Kapitulli i tetë ka të bëjë me investimet kapitale dhe atë të kategorizuara si në : tokë, ndërtesa dhe ndërtime, makineri dhe pajisje, përfshirë edhe kompjuterët, vetura dhe mjete tjera të transportit dhe ndërtime apo prodhime për nevojat e tyre.te kategorizuara sipas : e importuar ose e përdorur më parë në Kosovë,e përdorur më parë në Kosovë,renovime dhe përmirsime të mjeteve themelore fikse të blerë prej të tjerëve,kostoja e punës së bërë në llogari të vetë,vlera e shitjes së mjeteve themelore të biznesit dhe në Neto investimet

³ Kjo ndarje është kryer me kerkese te statistikave gjinore.

⁴ Ne baze te ligjit mbi pensionet ne Kosove biznesi eshte i obliguar qe te paguaj per pension (min) 4% të pagës bruto dhe në baza vullnetare deri në 15% të pages bruto

Për qëllime të identifikimit të investimeve negative dhe nxjerrjes së investimeve në shkallë vendi është aplikuar ky modul.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të anketës në tërësi, faqja e fundit e pyetësorit është paraparë për vërejtje dhe komente të të intervistuarve që kryesisht kanë qenë kontabilistët e ndërmarrjeve (bizneseve).

1.6. Procedurat e shpërndarjes, anketimit dhe mbledhjes së të dhënave

Shpërndarja e materialit tek njësit raportuese gjegjësisht në ndërmarrje si dhe mbulimi i terrenit është bërë përmes zyrave tona rregjionale në shtatë qendrat e mëdha të Kosovës⁵.

Anketimi – në të tri anketat jemi munduar të aplikojmë metodën e intervistimit të drejtpërdrejt (face by face) të bizneseve përmes anketuesve të ESK-së.

Por në të shumtën e rasteve në pamundësi të aplikimit të kësaj metode pyetsorët u janë dorëzuar personave përgjegjës pranë ndërmarrjeve me sqarimet dhe shpjegimet e nevojshme rreth plotësimit të tyre .

Pas plotësimit dhe konfirmimit nga ana e po të njëjtëve pas disa ditësh të njëjtit i kanë marrë të plotësuar. Vetëm tek një numër i vogël i ndërmarrjeve mundësitë për mbledhjen e të dhënave në mënyrë elektronike janë zbatuar.

Në mbledhjen gjegjësisht grumbullimin e pyetsorëve apo të të dhënave në kemi aplikuar metodat të cilat i kemi konsideruar më efikase për kushtet dhe rrethanat tona. Në mbi 70% të rasteve pyetsorët janë marrë nga vetë anketuesit , një përqindje e vogël janë sjellë nga vetë bizneset qoftë në zyret regjionale qoftë drejtpërdrejtë në zyren qendrore të ESK-së, një numër përmes postës dhe një numër fare i vogël përmes postës elektronike (e-mailit) .

1.7. Ngritja e të dhënave të anketës strukturore të ndërmarrjeve në nivel të vendit

Me qëllim të përfitimit të rezultateve nga anketa strukturore e ndërmarrjeve në nivel të vendit, të dhënat bazike nga anketa janë ngritur duke përdorur koeficientet.

Këta koeficientë janë kalkuluar si raport i vlerave të qarkullimit të ndërmarrjeve nga ASN për aktivitetet e caktuara dhe qarkullimit të përgjithshëm të të njëjtave aktivitete nga të dhënat e ATK-se.

Për verifikim të rezultateve të fituara sipas degëve janë përdorur edhe tregues tjerë si p.sh. numri i të punësuarve të deklaruar në ATK, llojet e caktuara të tatimeve të paguara etj.

⁵ Në strukturën organizative të ESK janë shtatë zyra rajonale të anketuesve që mbulojnë teretëritonin e Kosovës. Këto zyra janë të vendosura në qendrat e mëdha të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjiilan, Prizren, Pejë dhe Gjakovë.

2 Disa tregues dhe përkufizime themelore

Numri i bizneseve aktive gjegjisht bizneseve të cilat deklarojnë një nga llojet e tatimeve pranë ATK-së nëpër vite është pothuaj i përafërt dhe sillet rreth 40.000.

Ndërmarrja - është kombinimi më i vogël i njësive ligjore pra një njësi organizative që prodhon të mira apo shërbime, që ka njëfarë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj.

Ndërmarrja kryen një ose më tepër aktivitete ekonomike në një apo më tepër vendndodhje.

Nomenklatura e klasifikimit të veprimtarive ekonomike (NKVE) -

- është klasifikim standard apo nomenklaturë kombëtare e veprimtarive ekonomike i cili shërben për klasifikimin e bizneseve apo ndërmarrjeve të regjistruara sipas nivelit katërshifror të aktivitetit ekonomik të cilin ato e ushtrojnë gjatë ekzistimit gjegjisht afarizmit të tyre (NACE rev 1.)

Në bazë të rezultateve të nxjerra nga ASN për tri vitet vërehet se për nga numri i tyre mbi 20 mijë janë në sektorin e tregtisë dhe shprehur në % ato dominojnë në ekonominë Kosovare me 55 % të numrit të përgjithshëm. Numri i ndërmarrjeve në aktivitetet ekonomike gjegjisht prodhuese: të minierave, gjegjisht gurthyesve dhe separacioneve të zhavorrit, industrisë, energjisë si dhe ndërtimtarisë arrijnë mbi 6 mijë ndërsa punësojnë rreth 38 % të totalit të të punësuarve .

Investimet - përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjata të blera prej ndërmarrjeve ose të krijuara për llogari të vet me qëllim përdorimi për një periudhë jo më të vogël se 1 vit në procesin e prodhimit, përfshirë edhe tokën.

Prodhimi i aktiveve të qëndrueshme nga ndërmarrja për llogari të vetë përfshinë: prodhimin e të gjitha produkteve që prodhuesit e tyre i bëjnë për formimin e bruto kapitalit fiks për llogari të vet. Shënojmë se ky prodhim është gjithashtu pjesë e investimeve.

Vlera e qarkullimit - përfshinë shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë periudhës së marrë në shqyrtim dhe i korrespondon shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve ofruar të tjerëve.

Madhësia e ndërmarrjes – kriter për përcaktimin dhe kategorizimin e ndërmarrjeve sipas madhësisë ka qenë numri i të punësuarve . Varësisht prej specifikave dhe zhvillimit të vendit definohen edhe kriteret apo kufijtë për caktimin apo ndarjen e bizneseve sipas madhësisë .

Kështu prej 1 deri 9 – janë ndërmarrje të vogla , prej 10 - 49 të mesme dhe mbi 50 e më tepër të punësuar janë biznese të mëdha.

3 Numri i bizneseve, të punësuarve dhe paga mesatare

3.1. Numri i bizneseve sipas aktiviteteve ekonomike

Tabela 1. Korniza për mostër e bizneseve aktive⁶ për vitet 2005,2006 dhe 2007

<i>Seksionet</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>2005</i>	<i>2006</i>	<i>2007</i>
C	Minierat dhe industria nxjerrëse	144	152	154
D	Industria përpunuese	3,914	3,698	3,794
E	Prodhimi,shpërndarja e energjisë elektrike,gazit dhe ujit	13	17	18
F	Ndërtimtaria	1,894	1,648	1,658
G	Tregtia	20,281	18,985	22,185
H	Hotelet dhe restorantet	3,226	2,990	3,325
I	Transporti,postat dhe telekomunikacioni	3676	3110	3185
K	Shërbime biznesore	1,297	1,330	1,430
O	Shërbimet tjera	2,180	2,095	2,090
Gjithsej		36,625	34,025	37,839

Kriter për marrjen e biznesit si aktive ka qenë deklarimi i njërit nga tatimet . Do të thotë se në numrin total të popullacionit janë përfshirë të gjitha ato biznese të cilat gjatë vitit kalendarik kanë deklaruar njëren nga format e tatimeve të cilat janë në fuqi.


Përmes kësaj tablele vërejmë se numri i bizneseve aktive në sektorin e Tregtisë është dominant dhe shumë i përafërt për tri vitet dhe sillet në mes të 19.000 dhe 22.000.

Nëse bëjmë një krahasim në mes të dhënave të ASN-2007 dhe ASN-2006 vërejmë se në seksione te caktuara të veprimtarive ekonomike kemi ndryshime te vogla strukturore të numrit të bizneseve. Ka një ngritje te tregtisë nga 55.8 % sa ishte ne vitit 2006 ne 58.6 % 2007. ndërsa degët tjera kryesisht patën një rënie te lehte ne vitin 2007 krahasuar me vitin 2006. rënie me e theksuar u vërejte ne degën transport, post dhe telekomunikacion (nga 9.1% ne 8.4 %), shërbime tjera nga 6.2% (2006) ne 5.5 % (2007). Ndryshimet ne degët tjera janë me pak te theksuara., Industri përpunuese nga 10.9% (2006) ne 10.0% (2007), Ndërtimtari nga 4.8% (2006) ne 4.4%(2007), shërbime biznesore nga 3.9 % (2006) ne 3.8% (2007). Dega Hotele & Restorante kishte pjesëmarrje te njëjtë për të dy vitet me 8.8%.

⁶ në bazë të ATK-së

Tabela 2. Struktura e bizneseve sipas aktiviteteve ekonomike për vitet 2005, 2006 dhe 2007

Seksionet	Përshkrimi	2005	2006	2007
C	Minierat dhe industria nxjerrëse	0.4	0.4	0.4
D	Industria përpunuese	10.7	10.9	10.0
E	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, gazit dhe ujit	0.04	0.05	0.05
F	Ndërtimtaria	5.2	4.8	4.4
G	Tregtia	55.4	55.8	58.6
H	Hotelet dhe restorantet	8.8	8.8	8.8
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	10.0	9.1	8.4
K	Shërbime biznesore	3.5	3.9	3.8
O	Shërbimet tjera	6.0	6.2	5.5
Gjithsej		100.0	100.0	100.0



Një strukturë ndryshe nga kjo është ajo për numrin e të të punësuarve sipas degëve apo seksioneve të aktiviteteve ekonomike .

3.2. Numri i të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike

Me rastin e nxjerrjes së numrit të të punësuarve sikur u çek në parathënie janë shfrytëzuar koeficientet gjegjësisht peshat apo pjesmarrja e numrit të bizneseve me të punësuar nga mostra sipas sektoreve në numrin total nga ATK poashtu në kuadër të sektorit .

Numri i përgjithshëm i të punësuarve përgjatë tri viteve ka një trend rritjeje. Në këtë numër nuk bëjnë pjesë të punësuarit në degët ekonomike: bujqësi, pylltari, peshkim, financa dhe administrate publike si dhe në instiucionet apo organizmat ndërkombëtare. Këto diferenca tek numri i të punësuarve sipas viteve janë ngase edhe numri i bizneseve deklaruese pranë ATK-së si në total e poashtu edhe përnga madhësia dhe pjesmarrja e tyre në kuadër të sektoreve të aktiviteteve nuk ka qenë i njëjtë .

Tabela 3.– Numri i të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike - ASN 2005, 2006 dhe 2007


Seksionet	Përshkrimi	2005	2006	2007
C	Minierat dhe industria nxjerrëse	3,798	3,980	4,142
D	Industria përpunuese	8,149	12,038	13,013
E	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, gazit dhe ujit	9,858	10,929	10,091
F	Ndërtimtaria	5,792	5,681	5,722
G	Tregtia	19,253	23,935	23,128
H	Hotelet dhe restorantet	9,420	5,259	5,034
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	7,857	7,751	7,619
K	Shërbime biznesore	4,857	3,055	3,417
O	Shërbimet tjera	3,201	4,018	4,701
Gjithsej		72,185	76,646	76,867

Sa i përket strukturës së të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike vërehet se pjesa më e madhe e të punësuarve vazhdon të jete në degen e tregtisë me mbi 30% edhe pse në vitin 2007 patë një rënie krahasuar me vitin 2006 për 1.14% nga 31.23% (2006) në 30.09% (2007). Rënie në vitin 2007 krahasuar me vitin 2006 u shënuar edhe në këto dege: Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, gazit dhe ujit nga 14.26% (2006) në 13.13% (2007), Hotele dhe Restorante nga 6.86 % (2006) në 6.55% (2007), Transport, postë dhe telekomunikacion me nga 10.11% (2006) në 9.91% (2007). Ndërsa në degët tjera u vërejtë një ngritje e lehtë. Miniera, gurthyes dhe separacione të zhavorit nga 5.19% (2006) në 5.39% (2007), Industri nga 15.71 % (2006) në 16.93 % (2007), Ndërtimtari nga 7.41% (2006) në 7.44% (2007). Shërbimet biznesore 3.99% (2006) në 4.45% (2007) dhe shërbime tjera nga 5.24% (2006) në 6.12% (2007)

Po të krahasohet struktura e bizneseve dhe ajo e të punësuarve mund të konstatohet se sektori i tregtisë në Kosovë karakterizohet me numër të madh të ndërmarrjeve të vogla dhe me numër tejet të ulët të punësuarish, e të cilat kryesisht janë biznese familjare me një të vetëpunësuar. Derisa te struktura e ndërmarrjeve kishte rritje ndërsa te struktura e te punësuarve ka rënie. Ndërsa tek degët të cilat janë bartëse të punësimit (Industria përpunuese, Miniera dhe industri nxjerrëse, ndërtimtari) ndodh e kundërta.

Tabela 4.- Struktura e të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike ASN 2005,2006 dhe 2007

Seksionet	Përshkrimi	2005	2006	2007
C	Minierat dhe industria nxjerrëse	5.26	5.19	5.39
D	Industria përpunuese	11.29	15.71	16.93
E	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektr.,gazit dhe ujit	13.66	14.26	13.13
F	Ndërtimtaria	8.02	7.41	7.44
G	Tregtia	26.67	31.23	30.09
H	Hotelet dhe restorantet	13.05	6.86	6.55
I	Transporti,postat dhe telekomunikacioni	10.88	10.11	9.91
K	Shërbime biznesore	6.73	3.99	4.45
O	Sherbime tjera	4.43	5.24	6.12
		100	100	100



3.3. Paga mesatare sipas aktiviteteve ekonomike


Paga mesatare është një tregues me rëndësi. Ajo është kalkuluar (llogaritur) duke pjestuar pagat dhe mëditjet bruto⁷ për tërë vitin, me numrin e të të punësuarve dhe 12 muajt e vitit.

Treguesi i pagës mesatare në aktivitetet e përfshira në anketë është një tregues i përafërt me realitetin tonë. Siç edhe mund të vërehet paga mesatare më e lartë është në sektorin e Postë dhe telekomunikacionit, derisa ajo më e ulta është në sektorin e hotelarisë dhe restoranteve .

Tabela 5. Paga mesatare mujore sipas aktiviteteve ekonomike për vitet 2005, 2006 dhe 2007

		(në euro)		
Seksionet	Përshkrimi	2005	2006	2007
C	Minierat dhe industria nxjerrëse	188	324	254
D	Industria përpunuese	200	205	242
E	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, gazit dhe ujit	373	396	424
F	Ndërtimtaria	208	235	219
G	Tregtia	279	170	199
H	Hotelet dhe restorantet	156	152	199
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	556	578	600
K	Shërbime biznesore	200	286	255
O	Shërbimet tjera	211	375	203
Total		281	275	276

⁷ Në pagën bruto janë kunsideruar edhe pjesa e pensionit që pronari (ndërmarrja) paguan për punëtorin.



4 Qarkullimi dhe shpenzimet


4.1. Qarkullimi.

Vlera e qarkullimit përfshinë shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë periudhës së marrë në shqyrtim dhe i korrespondon shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve ofruar të tjerëve.

Tabela 6. - Struktura e qarkullimit sipas aktiviteteve ekonomike për ASN 2005, 2006 dhe 2007

Seksionet	Përshkrimi	2005	2006	2007
C	Minierat dhe industria nxjerrëse	0.62	0.87	1.54
D	Industria përpunuese	12.39	12.81	13.69
E	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, gazit dhe ujit	8.38	7.68	5.82
F	Ndërtimtaria	6.40	5.74	6.28
G	Tregtia	57.32	57.72	57.61
H	Hotelet dhe restorantet	1.54	1.33	1.29
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	9.95	10.64	10.43
K	Shërbime biznesore	1.94	2.12	2.21
O	Shërbimet tjera	1.46	1.09	1.13
Total		100	100	100

Sikurse edhe mund të vërehet në bazë të grafikut nr 4., tregtia si dege ka dominuar qarkullimin e realizuar nga ndërmarrjet sipas aktiviteteve ekonomike gjatë viteve të vrojtuarra (2005-2007) ne me mbi 57%. Kjo është në përputhje me treguesit tjerë që tregtinë e vënë në pjesëmarrjen më të lartë. Industria përpunuese është dege e dytë për nga qarkullimi dhe ka një tendencë të rritjes së pjesëmarrjes në qarkullimin e përgjithshëm nga 12.39% (2005), 12.81% (2006) duke arritur 13.69% (2007). Degët tjera me ndikim janë Transporti postar dhe telekomunikimi 9.95% (2005), 10.64% (2006) deri 10.43% (2007), Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, gazit dhe ujit 8.38% (2005), 7.68% (2006) dhe 5.82% (2007), Ndërtimtaria 6.40% (2005), 5.74% (2006) dhe 6.28% (2007). Kurse të tjerat veprimtari rezultojnë me një përqindje më të ulët të qarkullimit mvarsisht prej përfaqësimit të tyre në sektore të caktuara. Kështu në grupin e degëve ekonomike që kanë përqindje më të ulët të qarkullimit janë: hotelet dhe restorantet me 1.29% (2007), Minierat dhe industria nxjerrëse 1.54% (2007) Shërbimet biznesore dhe shërbimet tjera së bashku 3.34% 2007.




4.2. Shpenzimet

Tabela 7.-Struktura e shpenzimeve sipas aktiviteteve ekonomike për ASN 2005, 2006 dhe 2007

Seksionet	Përshkrimi	2005	2006	2007
C	Minierat dhe industria nxjerrëse	4.09	3.64	2.64
D	Industria përpunuese	6.74	6.18	7.16
E	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, gazit dhe ujit	10.33	8.49	8.05
F	Ndërtimtaria	5.38	6.09	7.96
G	Tregtia	64.35	64.51	62.06
H	Hotelet dhe restorantet	1.21	1.25	1.68
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	4.90	6.90	6.42
K	Shërbime biznesore	2.26	1.59	2.28
O	Shërbimet tjera	0.74	1.36	1.66
Total		100	100	100

Në bazë të tabelës strukturore të ASN për tri vitet lehtë mund të vërehet se struktura e pjesmarrjes së shpenzimeve sipas degëve ekonomike nëpër vite është pothuaj konsistente dmth. ndryshon tepër pak përjashtimisht tek shërbimet tjera ku ka një ndryshim më të theksuar.

Po ashtu bazuar nga të dhënat më lartë shohim se përqindja e pjesmarrjes së shpenzimeve është më e ulta tek restorantet 1,2% dhe tek shërbimet tjera 0,7% kurse shpenzimet më të theksuara janë në aktivitetin e tregtisë me rreth 64% çka edhe është reale dhe e pritshme kur kemi parasysh se edhe numri i bizneseve është me i larti gjegjësisht më i uliti tek seksionet në fjalë .



5 Shtojcë

Bizneset me përgjigje komplete sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë për ASN 2005, 2006 dhe 2007

Në tabelat në vijim kemi prezentuar numrin e bizneseve responduese (gjegjesisht bizneset që janë përgjigjur në anketë) sipas kategorisë së madhësisë. Vërehet se në vitin e parë përgjigjshmëria më e madhe ka qenë tek bizneset të cilat bëjnë pjesë në kategorinë e bizneseve të mesme.

Ndërsa në ASN-2006 dhe ASN-2007 shkalla e përgjigjshmërisë (responduese) ka qenë më e lartë tek kategoria e bizneseve të vogla .

Në baze të anketës strukturore të biznesit veçojmë faktin se 61% të ndërmarrjeve janë në kategorinë e ndërmarrjeve të mesme pothuajse në të gjitha aktivitetet, me përjashtim të sektorit të energjisë dhe shfrytëzimit të ujit ku numri më i madh i takojnë ndërmarrjeve të mëdha me 89%.e po ashtu vlen të theksohet se në këtë lloj veprimtarie nuk kemi asnjë ndërmarrje të vogël derisa në vitin e dytë dhe tretë kemi një numër edhe tek kategoria e bizneseve të vogla kjo ngase gjatë këtyre viteve kemi disa iniciativa për ngritjen e mini hidrocentraleve.

Tabela 1. Bizneset sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë për ASN 2005, 2006 dhe 2007 - (me përgjigje komplete)

Seksionet	Përshkrimi	Të vogla (0-9)			Të mesme(10-49)			Të mëdha (50 e mbi)			Gjithsej		
		2005	2006	2007	2005	2006	2007	2005	2006	2007	2005	2006	2007
C	Minierat dhe industria nxjerrëse	5	23	23	15	12	7	3	6	6	23	41	36
D	Industria përpunuese	61	146	152	266	104	92	34	34	37	361	284	281
E	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektr., gazit dhe ujit	0	3	3	1	2	2	8	7	5	9	12	10
F	Ndërtimtaria	36	85	80	177	58	63	15	14	7	228	157	150
G	Tregtia	664	847	745	714	230	219	24	24	16	1402	1101	980
H	Hotelet dhe restorantet	17	74	74	129	31	24	1	3	3	147	108	101
I	telekomunikacioni	30	42	46	76	20	15	10	7	7	116	69	68
K	Shërbime biznesore	17	40	32	39	26	16	7	12	4	63	78	52
O	Shërbimet tjera	16	11	15	56	10	5	17	10	7	89	31	27
	Gjithsejt	846	1.271	1.170	1.473	493	443	119	117	92	2438	1881	1705

Tabela 2. Struktura e bizneseve sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë per ASN 2005, 2006 dhe 2007 (me përgjigje complete)

Seksionet	Përshkrimi	Të vogla (0-9)			Të mesme(10-49)			Të mëdha (50 e mbi)			Gjithsej		
		2005	2006	2007	2005	2006	2007	2005	2006	2007	2005	2006	2007
C	Minierat dhe industria nxjerrëse	0,6	1,8	2,0	1,0	2,4	1,6	2,5	5,1	6,5	0,9	2,2	2,1
D	Industria përpunuese	7,2	11,5	13,0	18,1	21,1	20,8	28,6	29,1	40,2	14,8	15,1	16,5
E	Prodhimi,shpërndarja e energjisë elektr.,gazit dhe ujit	0,0	0,2	0,3	0,1	0,4	0,5	6,7	6,0	5,4	0,4	0,6	0,6
F	Ndërtimtaria	4,3	6,7	6,8	12,0	11,8	14,2	12,6	12,0	7,6	9,4	8,3	8,8
G	Tregtia	78,5	66,6	63,7	48,5	46,7	49,4	20,2	20,5	17,4	57,5	58,5	57,5
H	Hotelet dhe restorantet	2,0	5,8	6,3	8,8	6,3	5,4	0,8	2,6	3,3	6,0	5,7	5,9
I	Transporti,postat dhe telekomunikacioni	3,5	3,3	3,9	5,2	4,1	3,4	8,4	6,0	7,6	4,8	3,7	4,0
K	Shërbime biznesore	2,0	3,1	2,7	2,6	5,3	3,6	5,9	10,3	4,3	2,6	4,1	3,0
O	Shërbimet tjera	1,9	0,9	1,3	3,8	2,0	1,1	14,3	8,5	7,6	3,7	1,6	1,6
	Gjithsejt	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100

Enti i Statistikës së Kosovës përshkrim i shkurtër

Enti i Statistikës së Kosovës, është Ent profesional, vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Enti i Statistikës së Kosovës vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. Një Master Plan afatmesëm është duke u përgatitur për zhvillimin e sistemit statistikor kompatibil me Statistikat Evropiane.

Struktura organizative e ESK-së, katër *Departamente prodhuese* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave sociale dhe Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe ambientit), *shtatë Zyra Rajonale* (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj), *dy Departamente mbështetëse* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative dhe Departamenti i administratës), si dhe *Zyra e regjistrimit të popullsisë*, përbëjnë ndërtimin struktural të ESK-ës.

Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%) .

Kemi mbështetje dhe bashkëpunim profesional me institucionet ndërkombëtare.

Enti i Statistikës së Kosovës ka një terren krejtësisht të mbuluar në shkallë vendi. Për implementim e Anketave në terren përdorim mostrën dhe metodologjinë adekuate. Gjatë grumbullimit të raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale.

Një ekip i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

Misioni i Entit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë**
- **Telefonat: Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111**
Drejtori: +381 (0) 38 235 545
- **Fax: +381 (0) 38 235 033**
- **E-mail: ekonomik@ks-gov.net**
- **Ueb-faqe: www.ks-gov.net/esk**